



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2021

Lënda: Kthim përgjigje

**ZNJ.** \_\_\_\_\_

E nderuar ,

Në vijim të kërkesës Tuaj, drejtuar Bashkisë Shkodër me anë të postës elektronike me datë 13 prill 2021, Ju informojmë si vijon:

**I. Buxhetimi me pjesmarrje për diskutimin e buxhetit të vitit 2020 Programin buxhetor afatmesëm 2020 – 2022**

Bashkia Shkodër ju informon se përgatitja e Buxhetit të vitit 2020 dhe Programit buxhetor afatmesëm 2020 – 2022, vjen pas një procesi të gjatë pune. Ky proces ka ecur paralelisht me harmonizimin e dokumentave strategjike që Bashkia Shkodër disponon si dhe me organizimin e një sërë takimesh konsultative me aktorë dhe palë të interesuara për të adresuar nevojat konkrete të tyre. Sa më sipër është miratuar kalendari i hartimit të Programit Buxhetor Afat-Mesëm (PBA) dhe është përcaktuar veprimtaria e punës së Ekipeve të Menaxhimit të Programit (EMP). Këto ekipe janë angazhuar në organizimin e një sërë takimesh konsultative në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Shkodër. Pjesë e pa ndarë e këtij procesi kanë qënë edhe konsultimet e tjera publike të cilat Bashkia ka ndërmarrë gjatë zhvillimit të aktiviteteve të saj.

Bashkia Shkodër ka krijuar tashmë traditën e saj në buxhetimin me pjesmarrje dhe specifikisht buxhetimin gjinor. Bashkia Shkodër ka nënshkruar Kartën Evropiane në 8 Mars 2017, duke e bërë atë pjesë të dokumentave dhe instrumentave që orientojnë veprimet dhe hapat që ndërmerren në të gjitha aspektet e jetës: politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore. Përveç përkushtimit për hartimin e Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2018-2020 për një periudhë relativisht të shkurtër kohore, Bashkia Shkodër është e para bashki që caktoi në buxhetin e saj vjetor një zë dhe fonde përkatëse, pikërisht për aktivitete për zbatimin e Kartës Evropiane. **Materialin e plotë ku përfshihen raportet përmbledhëse, foto dhe listeprezencat e takimeve për vitin 2020 i gjeni të publikuar në faqen zyrtare të saj, në linkun:**

[http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Njoftim\\_per\\_keshillim\\_me\\_publikun\\_Per\\_draftin\\_e\\_projektplanit\\_buxhetor\\_afatmesem\\_2020\\_2022\\_dhe\\_ndryshimeve\\_ne\\_paketen\\_fiskale\\_te\\_Bashkise\\_1476\\_1.php](http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Njoftim_per_keshillim_me_publikun_Per_draftin_e_projektplanit_buxhetor_afatmesem_2020_2022_dhe_ndryshimeve_ne_paketen_fiskale_te_Bashkise_1476_1.php)

**Këshillim me Publikun**

**Njoftim për keshillim me publikun - Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe ndryshimeve në paketën fiskale të Bashkisë Shkodër"**

30.08.2019

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit nr. 149/2014 Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik në mesin 9 para 13, nënsh 24 të ligjit nr. 132/2015 "Për vetëvendosjen vendor", nënsh 24 të ligjit nr. 80/2017 "Për financat e vetëvendosjes vendor", ligjit nr. 95/96, datë 26.04.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të nryshuar, ligjit nr. 102/96, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurën standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJGV", Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 7 datë 27.02.2019 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2020-2022 dhe ndryshimet përtejones të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 20 datë 10.07.2019 "Për përgatitjen e buxhetit vendor", Bashkia Shkodër bën publik:

Draft projekt planit buxhetor afatmesëm 2020-2022 të Bashkisë Shkodër (matrica )

Jeni të ftuar të shprehni opinionin tuaj:

- 1.përmes Forumit Online të bazës zyrtare të internetit të Bashkisë Shkodër
- 2.përmes adresës zyrtare e-mail [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)
- 3.përmes pjesëmarrjes tuaj në objektet publike që do të mbanen sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Data	Ndësia Administrative	Ora	Vendi
1	E shtunë, 7 shtator 2019	Rrethina, Pult, Shosh, Shalik	16:00	Ndësia Administrative Rrethina
2	E enjte, 19 shtator 2019	Vellopajë	19:00	Ndësia Administrative Vellopajë, Sala e Mirëdijeve
3	E marre, 17 shtator 2019	Ana e Mallt	15:00	Ndësia Administrative Ana e Mallt, Sala e Mirëdijeve
4	E enjte, 12 shtator 2019	Bërdicë	15:00	Ndësia Administrative Bërdicë
5	E premte, 13 shtator 2019	Dajç	14:00	Ndësia Administrative Dajç, Sala e Mirëdijeve
6	E mërkure, 11 shtator 2019	Postribë	09:00	Ndësia Administrative Postribë, Sala e Mirëdijeve

3	E marre, 17 shtator 2019	Ana e Mallt	15:00	Ndësia Administrative Ana e Mallt, Sala e Mirëdijeve
4	E enjte, 12 shtator 2019	Bërdicë	15:00	Ndësia Administrative Bërdicë
5	E premte, 13 shtator 2019	Dajç	14:00	Ndësia Administrative Dajç, Sala e Mirëdijeve
6	E mërkure, 11 shtator 2019	Postribë	09:00	Ndësia Administrative Postribë, Sala e Mirëdijeve
7	E mërkure, 11 shtator 2019	Guri i Zi	13:00	Qendra Komunitare në Guri i Zi
8	E enjte 12 shtator 2019	Lagje nr. 3 Lagje nr. 4 Lagje nr. 5	10:00	Salla e Këshillit të Bashkisë Shkodër
9	E premte 13 shtator 2019	Lagje nr. 1 Lagje nr. 2	10:00	Salla e Këshillit të Bashkisë Shkodër
10	E premte 13 shtator 2019	Organizatë e Shoqësia Civile në fushën e shërbimeve sociale	11:00	Biuroveska "Matin Barleti" Shkodër

Raport i Këshillimit me Publikun NJA Ana e Mallt  
 Raport i Këshillimit me Publikun NJA Bërdicë  
 Raport i Këshillimit me Publikun NJA Dajç  
 Raport i Këshillimit me Publikun NJA Guri i Zi  
 Raport i Këshillimit me Publikun Lagjet nr. 1 dhe 2  
 Raport i Këshillimit me Publikun Lagjet nr. 3, 4 dhe 5  
 Raport i Këshillimit me Publikun NJA Postribë  
 Raport i Këshillimit me Publikun NJA Rrethina, Shalik, Shosh dhe Pult  
 Raport i Këshillimit me Publikun NJA Vellopajë  
 Raport i Këshillimit me Publikun me Organizatat dhe Shoqësitë Civile

Sherbime dhe kontakte  
 Facebook > Map >

Adresa  
 Rruga 13 Dhjetori, Nr. 1, Shkodër, Shqipëri  
 e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)

Sa më sipër, Bashkia Shkodër është vlerësuar ndër vite për transparencën dhe menaxhimin financiar, për zbatimin e të drejtës së informimit, konsultimit publik dhe llogaridhënien. Në vitin 2019 Bashkia Shkodër është renditur e para ndër 61 bashkitë vendit, sipas raportit të monitorimit “Pushteti Vendor nën Lentën e të Drejtës për Informim” përgatitur nga BIRN

Albania. Në raportin e Qendres Res Publica “E drejta e informimit 2019”, Bashkia Shkodër renditet e para ndër bashkitë me nje nivel të lartë të pikëve. (Publeaks, 2019).

Në vitin 2018 vlerësohet programi i transparencës së Bashkisë Shkodër nga Qendra për çeshtjet e Informimit Publik, INFOÇIP (2018), si programi më i mirë në Shqipëri. Ndërsa në vitin 2017 Bashkia Shkodër është vlerësuar me çmimin “Bashkia më Transparente 2017” në konkursin për transparencën me të gjitha bashkitë në vend.

## **II. Buxhetimi me pjesmarrje për diskutimin e buxhetit të vitit 2021 Programin buxhetor afatmesëm 2021 – 2023**

Bashkia Shkodër ju informon se për përgatitjen e Buxhetit të vitit 2021 dhe Programin buxhetor afatmesëm 2021 – 2023, ka patur në vëmendje të saj sigurimin e pjesmarrjes të qytetareve, ku ndonëse situata që po kalojmë nga Covid 19 ka afektuar aktivitetet e jetës së përditshme, edhe këtë vit nuk kanë munguar krijimi i lehtësirave për të siguruar buxhetimin me pjesmarrje. Përdorimi i mjeteve të komunikimit online të Bashkisë Shkodër, përdorimi i platformës së programit të transparencës dhe mbi të gjitha siguri i pyetsorit online për marrjen e mendimeve ka qënë risia e ketëj viti. Pjesëmarrës në dhënien e mendimeve dhe sugjerimeve kanë qënë 207 të intervistuar nga të cilët 38.2% gra dhe 61.8% burra, të cilët kanë përcaktuar prioritetet mbi nevojat e tyre në territor.

Gjithashtu duke marrë në konsideratë vështirësitë e krijuara nga Covid 19, Bashkia Shkodër është përpjekur që aktivitetet e saj ti përdorë edhe për garantimin e përcjelljes së zërit të qytetarëve në procesin e vendimarrjes. Njëkohësisht Bashkia Shkodër ka përthithur rekomandime edhe nga instituti AGENDA i cili ka ndërmarrë një projekt "Për pjesëmarrjen e qytetareve në hartimin e buxhetit të bashkisë, aplikuar për 61 bashkitë e vendit.

Këtë vit Bashkia Shkodër u vlerësua me çmimin e Praktikës më të mirë në fushën e Demokracisë Vendore për praktikën “Buxheti 2020 dhe PBA 2020-2022”, si dhe Këshilli Bashkiak Shkodër për përmirësimin e informimit dhe konsultimit publik për aspekte të financave publike, rritjen e transparencës dhe përdorimit të mjeteve të teknologjisë së informacionit.

Praktika e konsoliduar tashmë e konsultimit publik, diskutimit teknik ndërveprues ndërmjet administratës vendore dhe Këshillit Bashkiak, transparenca gjatë procesit të vendimarrjes për buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm, është vlerësuar nga Ministria e Brendshme dhe Agjensia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore në Konkursin e Praktikave të mira 2020, i mbështetur nga Agjensia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Për përgatitjen e Buxhetit të vitit 2021 dhe Programin buxhetor afatmesëm 2021 – 2023 Bashkia Shkodër ka publikuar në faqen e saj zyrtare dhe rrjetet sociale njoftimin për

zhvillimin e pyetsorëve online. Materialin e plotë mund ta gjeni të publikuar në faqen zyrtare të saj, në linkun:

Materialin e plotë për vitin 2021 mund ta gjeni të publikuar në faqen zyrtare të saj, në linkun:

[http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Njoftim\\_per\\_keshillim\\_me\\_publikun\\_Per\\_draftin\\_e\\_Projektplanit\\_Buxhetor\\_Afatmesem\\_2021\\_2023\\_te\\_Bashkise\\_Shkoder\\_1683\\_1.php](http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Njoftim_per_keshillim_me_publikun_Per_draftin_e_Projektplanit_Buxhetor_Afatmesem_2021_2023_te_Bashkise_Shkoder_1683_1.php)

The image shows two screenshots. The top one is a screenshot of the official website of Bashkia Shkodër. The page title is "Njoftim për keshillim me publikun - Për draftin e Projektplanit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 të Bashkisë Shkodër". The date is 27.08.2020. The text explains the process of public consultation for the budget plan, citing various laws and regulations. It lists the following points:

- 1. Forumit On-Line të faqes zyrtare të internetit të Bashkisë Shkodër,
- 2. adresës zyrtare e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)
- 3. kërkesave buaja në Zyrat e Integruara me Një Ndalësë të Bashkisë Shkodër dhe Njëvise Administrative.
- 4. pletesimit të [anketes on line](#)


The bottom screenshot shows a Google Forms survey page titled "Konsultim i draftit të Projektplanit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2021- 2023 i Bashkisë Shkodër". The form is no longer accepting responses, and the message says: "The form Konsultim i draftit të Projektplanit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2021-2023 i Bashkisë Shkodër is no longer accepting responses. Try contacting the owner of the form if you think this is a mistake."

Konsultimi i buxhetit të bashkisë është bërë për çdo program buxhetor; zhvillimi ekonomik, turizmi, investimet, shërbimet publike, shërbimet sociale, etj., me shoqërinë civile, komunitetin, biznesin dhe palë të interesuara.

Njëkohësisht është përdorur edhe **Platforma Transparenca e Buxhetit**

Kjo platformë është integruar në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër. Bëhet fjalë për një platformë e cila bazohet në automatizim procesesh. Instrumenti ndahet në 3 kategori kryesore, të ardhurat - shpenzimet dhe taksat e mia. Ky instrument ka të integruar dhe një hartë të bazuar në platformën google maps e cila lokalizon hartën e bashkisë Shkodër, të ndarë me njësitë administrative të saj.

Nisma jonë fillon që në vitin 2016 si një raportim të aktiviteteve të realizuara për të gjithë qytetarët e Bashkisë Shkodër. Në instrument është përfshirë viti 2016 – 2020. Natyrisht është një proces që do të përditsohet çdo ditë me informacion, për me shumë vizitoni linkun <https://buxheti.info/shkoder/>



Të gjitha të dhënat e listuara më sipër janë të aksesueshme në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër: [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al)

Me respekt,

**KRYETAR**

**Voltana Ademi**

Konceptoi: S. Mardusha

Miratoi: R. Sokoli